



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.831/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllagjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtuar nga Rrezarta Krasniqi, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Rrezarta Krasniqi, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, në Vendvotimet nr.2701B/09R, 2714B/01R, në Vushtri.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Rrezarta Krasniqi, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, me të cilën ka pretenduar se i është bërë e padrejtë për faktin se rezultatet e votave të numëruara nga KVV-të në vendvotimet e Vushtrrisë dhe ato të rinumëruara në QNR janë në rregull, mirëpo me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja me datë 08.11.2017, ka diskrepancë në numrin e votave në FPR dhe numrin e votave të publikuara në faqe të KQZ-së, në Vendvotimet nr.2701B/09R, 2714B/01R, në ..

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazeshemeris se apelit dhe vlerësimit të shkresave në lëndë, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore ne apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit te provave dhe shkresave të lëndës, paneli ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i miratoj apelin e apeluesit si te bazuar dhe urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.831/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.